



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 04  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S - I  
Prishtinë, më 8 nëntor 2017, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

**Mungoi:** Faton Topalli.

**Të ftuar:** Andrew Russell, koordinator për zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues rezident i UNDP në Kosovë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Elisabeta Lurelev-UN/DCO, Ervin Ibrahim - UNDP, Anita Bekteshi – UNDP, Rebecca Butringer – UNDP dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Shprese Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**REND I DITËS**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takimi me z. Andrew Russell, koordinator për zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues rezident i UNDP- së në Kosovë;**
- 3. Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

## 2. Takimi me z. Andrew Russell, koordinator për zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues rezident i UNDP- së në Kosovë

**Kryetarja** e përshëndeti z. Andrew Russell, koordinator për zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues rezident i UNDP- së në Kosovë. Falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë UNDP- së përmes programeve dhe projekteve të tyre. Fjalën ia dha z. Russell për prezantimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

**Andrew Russel:** Faleminderit, është kënaqësi të jem me ju dhe të bisedojmë së bashku për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Jemi këtu që së bashku me institucionet e Kosovës të vazhdojmë bashkëpunimin dhe të punojmë në interes të qytetarëve. Sot do të diskutojmë për agjendën globale të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Agjenda globale përmban 17 objektiva për një zhvillim të qëndrueshëm, e që në fokus kanë kryesisht shërbimet e mira shëndetësore dhe arsimore. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë:

1. Eliminimi i varfërisë.
2. Eliminimi i urisë dhe ngritja e cilësisë së të ushqyerit.
3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqenies së njerëzve të gjitha moshave.
4. Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe e drejta e njerëzve për të mësuar gjatë gjithë jetës.
5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave.
6. Sigurimi i pajisjes dhe administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve për të gjithë.
7. Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne dhe me çmim të përballueshëm.
8. Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme përmes punësimit në kushte humane dhe të denja, për të gjithë.
9. Ndërtimi i infrastrukturës rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitja e inovacionit.
10. Zvogëlimi i pabarazisë ndërmjet të vendeve dhe mes tyre.
11. Kthimi i qyteteve në vendbanime gjithëpërfshirëse, të parrezikshme, rezistuese dhe të qëndrueshme.
12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.
13. Lufta kundër ndryshimit klimatik dhe efekteve të tij.
14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare.
15. Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave të gjelbra në shkretëtirë, ndalimi i degradimit të tokës dhe humbjes së biodiversitetit.
16. Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimit të qëndrueshëm duke afruar drejtësi për të gjithë, përmes të ngritjes së institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse, në të gjitha nivelet.
17. Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.

Pra, në këto objektiva janë të përfshira tema të fuqishme si është, rritja e pabarazia në shumë shtete të botës, pastaj fokus i veçantë është te ndryshimi klimatik, ku çdo pjesë e botës ka

probleme klimatike, edhe në Kosovë këto probleme janë prezentë. Objektivi i tretë lidhet me fokusin që të kemi një jetë të shëndetshme. Ky është një objektivi shumë i rëndësishëm për ju. Pastaj objektiva për të pasur një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe e drejta e njerëzve për të mësuar gjatë gjithë jetës. Në Kosovë këto objektiva mund të përdoren për angazhimin e të rinjve në projekte të ndryshme në mënyrë shumë kreative.

Gjithashtu objektiva e arritjes së barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave, është arritur shumë në këtë fushë në Kosovë, megjithatë akoma ka shumë vajza që janë jashtë shkollës siç ka edhe në shumë vende të botës.

Ndryshimet klimatike, në Kosovë ka shumë potencial për në zhvillimin e energjisë solare dhe të hidroenergjis, por ka ngecje. Megjithatë nuk është vonë që të ndërmerren hapa në këtë drejtim.

Në Kosovë ka radikalizëm dhe ekstremizëm po nuk ka më shumë që ka në shumë shtete të botës.

Ju e keni një popullatë me shumë diversitet dhe gjithë përfshirja është shumë e rëndësishme.

Jeni në progres të vazhdueshëm, por edhe duhet të jeni krenar për të arriturat që i keni bërë qoftë në nivel parlamentar, qoftë në nivele të tjera.

Nga perspektiva e Kombeve të Bashkuara agjenda e zhvillimit globale dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm janë mundësi për Kosovën që të dëgjohet në tregun global.

Objektivat globale nuk i përkasin vetëm Kombeve të Bashkuara, por ju përkasin shteteve të cilat do t'i zbatojnë. Nuk ka fonde magjike për t'i realizuar, por duhet angazhim i vet shteteve e që UNDP do ju ndihmoj në përmbushjen e këtyre objektivave. Kosova ka shumë sfida dhe shumë probleme, por ju duhet të jeni krenar për atë që keni arritur. Njëra nga rrolet e Parlamentit është që duke i mbështetur këto objektiva të jep një mesazh se po përmbushen këto objektiva dhe ky do jetë një indikator global. Ju duhet të përfshiheni në iniciativa të ndryshme globale dhe të zhvillonit shtetin tuaj. Disa nga këto ide do jenë të përfshira në rezolutën parlamentare dhe janë brenda deklaratës së 2030. Kjo është e lidhur edhe me përmirësimin e mirëqenies së njerëzve të Kosovës. Hapat e ardhshëm janë që të bashkëpunojmë me ju që të finalizojmë dhe të kalojmë në Kuvend rezolutën e që do jetë një pikë referuese për përmbushjen e objektivave, por zhvillim të qëndrueshëm.

Kam një respekt për punën tuaj dhe ju duhet ta keni parasysh që ne jemi të gatshëm të ju përkrahim në përmbushjen e objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

**Besa Baftiu:** Falënderoi z. Russel për prezantimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe gatishmërinë për bashkëpunim në adresimin e përmbushjes së këtyre objektivave. Bashkëpunimi mes nesh do të jetë shumë i ngushtë në përgjithësi e respektivisht në adresimin këtyre objektivave, pse jo edhe përmes komisionit, Kuvendit të Kosovës. Ne kemi legjislacion ku adresohen apo rregullohen këto fusha që i prezantuat, mirëpo kemi ngecje në zbatimin e këtij legjislacioni. Ne besoj se nga ju do të kemi mbështetje në të ardhmen pse jo edhe gjatë shqyrtimit të projektligjit për ndërmarrjet sociale i cili do të shqyrtohet shumë shpejt në komision. I cili e prek barazinë gjinore, grupet e cënueshme ku kanë ndërlidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshme.

**Naser Rugova:** E përshëndeti z. Russell! Shprehim konsideratë të lartë për punën që ka bërë dhe po e bën UNDP në Kosovë. Këto 17 objektiva e zhvillimit të qëndrueshme që prezantuat po thuajse prekin të gjitha sfidat, apo nevojat me të cilat ne po ballafaqohemi dhe do të ballafaqohemi edhe në të ardhmen. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshme, si dhe Objektivat e Mileniumit kanë në si energji mes vete dhe duhet të jetë një mesazh konkret për institucionet tona në adresimin e tyre. Ne duhet të koordinohemi si komision, Kuvend, Qeveria, OJQ, grupet Think Thank që në prag të 10- vjetorit kremtimit të pavarësisë duhet të përmbyllim fazën tranzicionit, si në sektorin e shëndetësisë, arsimit dhe sektorë të tjerë. Kanë ardhur shumë

praktika modele nga vendet e ndryshme, mirëpo gjendja nuk është e mirë, andaj ne duhet të përgatisim një strategji të qëndrueshëm të zhvillimit për këta dy sektorë. Agjencitë e OKB-së dhe Organizatat e tjera kanë dhënë miliona euro, mirëpo s'kemi parë rezultate të prekshme, andaj duhet të kemi kujdes, si gjatë hartimit të strategjive dhe legjislacionit dhe të kemi reforma konkrete që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve. Ne do të kemi një bashkëpunim, mirëpo presim edhe mbështetje konkrete nga ju.

**Flora Brovina:** E përshëndeti z. Russell! Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë për kontributin që ka dhënë përmes programeve në Kosovë. Objektivat që i prezantoi shpeshherë ne ngecim në përmbushjen këtyre objektive pasi që jemi shoqëri e dalë nga lufta. Ne ende s'kemi kërkim falje nga shteti i Serbisë, po ashtu akoma kemi ende viktimat të zhdukura që nuk dihet për fatin e tyre, pra ne ende ballafaqohemi me pasojat e luftës. Na duhet kohë dhe mbështetje konkrete për adresimin e gjitha këtyre objektive. Ne akoma si shtet s'kemi mundur që t'i ofrojmë mbështetje sa duhet për kategoritë e dala nga lufta, në këtë rast viktimave të dhunuara gjatë luftës, familjeve të dëshmorëve dhe kategorive të tjera. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshme pa tjetër duhet adresuar një nga një përmes veprimeve konkrete. Ne, si komision, do të kemi një bashkëpunim të ngushtë me ju dhe gjitha institucionet tjera për adresimin e këtyre objektive. Prezantoi sfidat dhe vonesat që janë shkaktuar edhe përkundër se kaluan shumë vite pas përfundimit të luftës dhe shpalljes së pavarësisë. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe objektivat e Mileniumit janë të rëndësishme dhe duhet patjetër adresuar në të ardhmen se janë në interes të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve. Kërkojmë edhe në të ardhmen mbështetjen tuaja ne përmbushjen apo adresimin e këtyre objektive.

**Time Kadrijaj:** E përshëndes z. Russell! E falënderoi për prezantimin e objektiveve. Dhe gatishmërinë për bashkëpunim me Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale i cili mbulon dy fusha të rëndësishme të veçantë. Shumica e organizatave hezitojnë të bashkëpunojnë me këtë komision duke e ditur se është pak më vështirë dhe duhet mbështetje konkrete, pra shkojnë e bashkëpunojnë me ato komisione që kanë me pak punë dhe me të lehte në adresimin e problemeve. Kurse problemet në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale me vështirë është të bëhen ndryshime të prekshme dhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Ne, si komision, jemi duke punuar maksimalisht në adresimin e problemeve, si gjatë procesit të amendamentimit dhe monitorimit të legjislacionit. Ne ofrojmë bashkëpunimin tonë, si komision në adresimin e këtyre objektive pse jo të shohim edhe praktikën e vendeve të tjera, se si janë adresuar këto objektiva.

**Haxhi Avdyli:** E përshëndes z. Russel! Ju falënderojmë për përkushtimin e juaj për të ndihmuar Kosovën në arritjen e këtyre objektiveve. Ne vlerësojmë mbështetjen tuaj në sektorin e shëndetësisë. Kërkojmë që të na njoftoni për planifikimet e juaja për mbështetjen në të ardhmen si për sektorin e shëndetësisë dhe sektorët tjerë. U prezantuan çështjet më të cilat ne jemi ballafaquar pas luftës e të cilat duhet të merren parasysh. Burimi i konflikteve vije si rezultat i pa barazisë apo drejtësisë. Kosova ka bërë shumë përpjekje të mëdha që të përmirësojë gjendjen e pakicave në Kosovë dhe shpesh herë i kemi tejkaluar konventat ndërkombëtare në raport me përmirësimin e të drejtave të pakicës, si dhe shpeshherë i kemi harruar të drejtat e shumicës. Ne jemi përkrahës i të drejtave të pakicave, mirëpo duke i përmirësuar të drejtat e pakicave t'i cenojmë të drejtat e shumicës dhe të krijojmë pa barazi mes qytetarëve. Siç e kemi rastin edhe me Asociacionin për komunat serbe, pra nuk theksohet se do të kenë të drejtë edhe komunitetet e tjera. Kurse tek Asociacioni i komunave të Kosovës trajtohen në mënyrë të barabartë gjitha komunat. Pra, në këtë rast pa barazitë sjellin deri te konfliktet dhe në këtë rast duhet të kemi kujdes gjatë hartimit të politikave të reja në barazinë dhe jo diskriminimin e asnjë pjesë apo

komuniteti. Unë e shprehi si shqetësim për të ardhmen dhe kujdesin e shtuar që duhet të kemi në raport me barazinë e gjithë qytetarëve. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm qëllimi i tyre është barazia dhe paqja mes qytetarëve e në këtë rast duhet të kemi kujdes mos të krijojmë pa barazi apo diskriminim. Shpresojmë se do të kemi një bashkëpunim të ngushtë mes nesh në adresimin e këtyre objektivave.

**Fatmire Kollçaku-Mulhaxha:** E përshëndeti z. Russel! Ju falënderojmë për prezantimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe gatishmërinë për bashkëpunim. U theksuan shumë gjëra që ne, si Kosovë, jemi përballuar. Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë edhe me e pa zhvilluara, mos t'i përmendim edhe pasojat nga lufta. Ju theksuat se s'do të këtë buxhet siç theksuat magjik për adresimin e këtyre objektivave dhe barra kryesore do të na bijnë neve, si shtet në adresimin e këtyre objektivave. Ne, si komision, do të kërkojmë nga ministritë gjatë hartimit të politikave të reja që t'i kenë parasysh adresimin e këtyre objektivave, pra t'i kenë parasysh. Theksoj se si komision ballafaqohemi me dy sektorët më të ndjeshëm apo më kategoritë më të cenueshme të shoqërisë sonë. Qeveria duhet të këtë parasysh orientimin e buxhetit në adresimin dhe përmbushjen e këtyre objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Jemi të vetëdijshme se ne, si vend i vogël do të jetë sfidë në adresimin e tyre me një buxhet të vogël dhe një ekonomi të pa zhvilluar. Përmbushja e këtyre objektivave do të jetë sfidë edhe për vendet me një zhvillim të lartë ekonomik. Kërkojmë mbështetje konkrete, qoftë në komision, qoftë përmes institucioneve të tjera përmes jush apo organizatave tjera, të na mbështetni qoftë përmes ekspertëve apo vizitave që t'i shohim nga afër se si vendet e tjera i kanë adresuar këto problematika në mënyrë që edhe në të kemi më lehtë adresimin e tyre. Tek objektiva e 16 parashihet roli që duhet të kemi ne, si Kuvend, ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënës dhe gjithë përfshirëse. Cila do të jetë mbështetja konkrete për Komisioni tonë?

**Bekim Haxhiu:** E përshëndeti z. Russel! Ju falënderojmë për prezantimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Shumica e gjërave u theksuan nga kolegët. Ne, si komision, afrojmë gatishmëri për adresimin e tyre në të ardhmen.

**Besa Baftiu:** I nderuar z. Russell, siç i dëgjuat gjithë kolegët shprehen gatishmërinë për një bashkëpunim të ngushtë dhe konkret me komisionin. Po ashtu i dëgjuat shqetësimet edhe pyetjet e deputeteve. Urdhëroni keni fjalën!

**Andrew Russell:** Ndoshta duhet t'ju kërkoj falje sepse është dashur që ky takim të mbahet më herët dhe se pajtohem që komisioni juaj nuk ka marrë mbështetjen e duhur duke pas parasysh fushën të cilën e mbulon. Do jemi të lumtur që me ju të punojmë më shumë. Do t'i shohim mundësit dhe hapat që do t'i marrim që të ju ndihmojmë në realizimin e detyrave tuaja. Kemi punuar në disa projekte me shtetin e Norvegjisë dhe jemi duke par mundësin në bashkëpunim edhe në projekte të tjera. Kemi bashkëpunim edhe me Kroacinë të cilët po na ndihmojnë me ekspertë në realizimin e projekteve konkrete, e në këto projekte do ta kycim edhe bashkëpunimin me ju. Fillimisht do të bashkëpunojmë në miratimin e rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, e pastaj do ta vazhdojmë bashkëpunimin edhe në çështje të tjera, ndoshta edhe në disa vizita në shtete fqinje. Mundësit buxhetore tonat nuk janë të mëdha, por prapë me një bashkëpunim mund të arrijmë më shumë. Sa i përket shëndetit mental është një sfidë shumë e madhe dhe ka shumë presion në gjeneratat e reja, por ne duhet të fokusohemi më shumë që të marrë më shumë vëmendje shëndeti mendor. Në shtete pas konfliktit ka shumë probleme dhe situata e Kosovës është shumë unike, ka shumë sfida edhe sa i përket të drejtave të minoriteteve por Kosova është fituese e luftës dhe tani duhet të merret me sfidat e ndërtimit të shtetit. Është

koha që UNMIK-u t'ju ndihmojë në qëllimet tuaja dhe se ju jeni të orientuar drejt BE-së, dhe ju duhet të përkraheni në rrugën tuaj. Sa i përket liberalizimit dhe pjesëmarrjes në CEFTA nuk di çfarë të ju them, këto janë sfida tuajat. Angazhimi juaj në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm do ju ndihmojë edhe në raportet tuaja në integrimet evropiane. Dëshiroj që pas dhjetë viteve pavarësi të bisedojmë për të arriturat tuaja dhe t'ju ndihmojmë të rinjtë që ta ndejnë veten si kosovarë.

Mendoj që Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe agjenda globale janë të dobishme për ju në sfidat që ju presin.

**Besa Baftiu:** Ne kërkuam mbështetje konkrete fillimisht të shqyrtimi i projektligjit për ndërmarrjet sociale i cili në një mënyrë ndërlidhet me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Po besojmë se do të kemi një bashkëpunim të ngushtë edhe në të ardhmen. Ju falënderojmë për kohën edhe gatishmërinë tuaj për bashkëpunim.

### **3. Të ndryshme:**

Për këtë pikë, nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

**E përgatiti:**  
**Stafi i mbështetës i Komisionit**

**Kryetarja e komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**